



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 5, datë 10.03.2025

PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PREJ 400 703.84 (KATËRQINDMIJË E SHTATËQIND E TRE, PIKË TETËDHJETË E KATËR) LEKË, PËR PASURITË PRONË PRIVATE, SIPAS TABELËS SË HARTUAR NGA GRUPI I PUNËS, I NGARKUAR PËR KRYERJEN E VLERËSIMIT PARAPRAK, DHE ËSHTË PJESË E KËTIJ VENDIMI, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT: “RIKONSTRUKSION RRUGE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ISHËM”

Në mbështetje të nenit 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9, pika 1.2/b të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, sipas relacionit të ardhur nga Drejtoria Ligjore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:



1. Miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit prej 400 703.84 (katërqindmijë e shtatëqind e tre, pikë tetëdhjetë e katër) lekë, për pasuritë pronë private, sipas tabelës së hartuar nga grupi i punës, i ngarkuar për kryerjen e vlerësimit paraprak, dhe është pjesë e këtij vendimit, që preken nga investimi publik me objekt: “Rikonstruksion rruge në Njësinë Administrative Ishëm”.
2. Fondi i shpronësimit me vlerë 400 703.84 (katërqind mijë e shtatëqind e tre, pikë tetëdhjetë e katër) lekë të parashikohet në buxhetin e vitit 2025. Lëvrimi i fondit do të kryhet pasi të jetë botuar VKM-ja për shpronësim.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria Ligjore.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 11.03.2025



BASHKIA Durrës


LISTA PARAPIRAKE E PRONAVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI: RIKONSTRUKSIONI RRUGA ISHIEM

Nr.	PRONARI										VLERESIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT TË PASURISË				
	Emër	Afisi	Mblenës	Z.K	Nr. Pas	Lloji pas	Sip. Tot	Trrall	Avë	Ndërtues	Volum	Faqe	Sip. (nr ²)	C. nimit (tekg/m ²)	Vlera (tekg)
1	Gjok	Lazer	Lazer	1522	150/53	Ave	4134		PO	1	187	142.34	320	45548.8	
2	Mylar		Lameshi	1522	154/2	Ave	4717		PO	1	184	44.77	320	14326.4	
3	Alfred, Mirjan		Lazer	1522	150/07	Ave	915		PO	4	169	13.07	320	4182.4	
4	Agron		Bara	1522	150/93	Ave	600		PO	4	165	160.19	320	51260.8	
5			Insiela 6 vllazert shpk	1522	153/40	Ave	12528		PO	7	170	359.94	320	115180.8	
6			Murat Group 012	1522	153/39	Ave	3098		PO	8	210	11.1	320	3552	
7	Zel	Jak	Canaj	1522	153/38	Ave	1180		PO	5	182	29.38	320	9401.6	
8	Elton	Bahir	Nuri	1522	150/163	Trrall	166.66	PO		6	109	44.96	330	15241.44	
9	Dritan		Isbaku	1522	150/164	Ave	166.67		PO	6	110	27.49	320	8796.8	
10	Muharrem		Kapollit	1522	148/5	Ave	564		PO	3	57	69.84	320	22348.8	
11	Shet			1522	148	KENEFTE	6100		KENEFTE	2	240	1136.86	0	0	
12	Mikel, Edlira		Resi	1522	147/91	Ave	500		PO	4	121	27.08	320	8665.6	
13	Artur	Gjergj	Muen	1522	150/176	Ave	500		PO	7	183	86.76	320	27763.2	
14	Miranda, Doran	Perparim	Boony	1522	147/136	Ave	1084		PO	7	194	192.32	320	61542.4	
15	Tosnor	Sat	Simoni	1522	147/46	Ave	500		PO	3	117	28.93	320	9257.6	
16	Abdulla		Hoxha	1522	147/24	Ave	360		PO	3	20	11.36	320	3635.2	



TOTALI	2386.39 m2	400703.84	(katerqind mije e shtateqind e tre pike tetedhjetë e kater lek)
---------------	-------------------	------------------	---

Grupi i Punës:
Enli Kacali
Aleks Prenga
Jemir Kurti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 184/3 prot.

Durrës, më 17.3.2025

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS ✓

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.5 datë 10.03.2025, "Për miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit prej 400 703.84(katërqindmijë e shtatëqind e tre pikë tetëdhjetë e katër) lekë, për pasuritë pronë private , sipas tabelës së hartuar nga grupi i punës , i ngarkuar për kryerjen e vlerësimit paraprak, dhe është pjesë e këtij vendimi, që preken nga investimi publik me objekt:"Rikonstruksion rruge në Njësinë Administrative Ishëm".

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

